

# Këpurdhat më të rrezikshme në Suedi!



- Mos mblidhni këpurdha që duken si në broshurë!
- Mblidhni vetëm ato këpurdha për të cilat jeni të sigurtë se i njihni!
- Mos i shijoni këpurdhat për t'i provuar fare! Edhe këpurdhat helmuese mund të kenë shije të këndshme!
- Vetëm një i rritur që njeh këpurdhat le t'i pastrojë ato!
- Gjeneroni ndonjë libër bashkëkohor mbi këpurdha!



## Qeleposhe, Pikaloshe

*Amanita muscaria*

Kapela 10–25 cm. Kapela mund të ketë ngjyra të ndryshme, prej një ngjyre të mbyllur të kuqe deri në një ngjyrë të kuqe në të portokalltë. Pikat i ka të bardha. Në këmbë ka një unazë të gjërë ndërsa pjesa e poshtme e këmbës është e fryer. Rritet në pyje gjetherënës dhe halorë.



## Qeleposhe (Pikaloshe) ngjyrë gështenjë

*Amanita muscaria var. regalis*

Kapela ngjyrë gështenje dhe gështenje në të verdhë, ka pika të bardha në të verdhë. Këmba ka një unazë të dukshme ndërsa pjesa e poshtme e këmbës është e fryer. Rritet në pyje halorë.



## Qelposhe panter

*Amanita pantherina*

Kapela është 5–12 cm dhe me ngjyrë nuancash të gështenjta. Pikat i ka të bardha, unaza në këmbë i mungon nganjëherë. Pjesa e poshtme e kapelës është e fryer. Zakonisht rritet në pyje gjetherënës dhe parqe, mirëpo nganjëherë mund të gjendet edhe në pyje halorë.

Këto tri lloje këpurdash kanë kapelë me pika. Mirëpo pikat mund t'u bien dhe t'u mungojnë krejtësisht ose pjesërisht.

### Efektet dhe simptomat e helmit

Të gjitha këto këpurdha përmbajnë helm që ngacmon sistemin nervor. Mund të shkaktojë marramendje, hutim, shqetësim, vetëdije të dobësuar dhe ngërçe. Nganjëherë edhe ligështi dhe vjellje.

### Si mund të mësoni më shumë mbi këpurdhat?

- Provoni të vijoni ndonjë kurs mbi këpurdha ose të shkoni në ndonjë ekskursion pylli. Ka organizata studimore dhe shoqata që organizojnë gjëra të tilla.
- Faqe të mira interneti: [www.svampkonsulent.se](http://www.svampkonsulent.se) • [www.svampguiden.com](http://www.svampguiden.com)

**112** Telefononi në 112 në rast se dikush helmohet dhe kërkoni informata mbi helmet – në çdo kohë. Telefononi në 010-456 6700 për raste më pak urgjente • [www.gic.se](http://www.gic.se)



## Engjëllushë shkatërrimtare

*Amanita virosa*

E tërë kapela është e bardhë. Kapela 5–12 cm. Këmba ka një unazë, mirëpo unaza nganjëherë i mungon. Kur Engjëllushat shkatërrimtare janë sapo të çelura ato i ngajnë vesë. Pjesa e poshtme e këmbës, që në të shpeshtën e herave gjendet thellë në myshk, është e fryer. Engjëllusha shkatërrimtare rritet në pyje halorë me myshk dhe ahishtë.

### Efektet dhe simptomet e helmit

Helmi lëndon mëlçinë. Shenja të helmimit janë diarri të holla si uji, ligështi dhe vjellje që mund të paraqiten pas një kohe të gjatë pasi t'i keni ngrënë. Rreziku për lëndim serioz të mëlçisë është i madh. Helmimi mund të shpie deri te vdekja.



## Kryevrastare

*Amanita phalloides*

Kapela 5–12 cm. Ngjyra e kapelës mund të ndryshojë, prej gati tërësisht të bardhë deri te nuanca të gjelbërta dhe gështenj të ndritshme. Petat i ka të bardha. Këmba ka një unazë të hollë, por nganjëherë edhe i mungon. Pjesa e poshtme e këmbës është e fryer. Kryevrastarja rritet në pyje gjetherënës, pyje të përziara (pyje gjetherënës dhe halorë) dhe në livadhe me ah, bung dhe lajthia.

### Efektet dhe simptomet e helmit

Përmban po atë helm si edhe Engjëllusha shkatërrimtare. Shkakton simptome të njëjta dhe është poaq e rrezikshme.



## Vrastare me vello majuc

*Cortinarius rubellus (C. speciosissimus)*

Kapela 4–8 cm. E tërë këpurdha ka ngjyrë të kuqe në të gështenj të ose të verdhë në të gështenj të. Kapela në të shpeshtën e herave është me majë, mirëpo jo gjithmonë. Rritet në pyje halorë dhe ahishte të pasura me myshk. Një lloj i ngjashëm që përmban helm identik është E përflakura e çarë (*C. orellanus*). Rritet në pyje gjetherënës me bung, ahishte dhe lajthia.

### Efektet dhe simptomet e helmit

Helmi lëndon veshkët dhe mund t'i shkatërrojë ato tërësisht. Shenjat e helmimit paraqiten pas disa ditësh. Ato mund të jenë etje të shtuar, dhembje muskujsh, sasi të shtuar ose pakuar të urinës. I helmuari mbase do të ketë nevojë për trajtim me dializë për një kohë të gjatë e ndoshta edhe transplantim të veshkëve.



## Shpunge e rreme

*Gyromitra esculenta*

Shpunga e rreme bën pjesë në një grup krejt tjetër të këpurdhave. Kapela është 4–12 cm, e gështenj të, e rumbullakët dhe e paluar. Këmba mund të ketë ngjyra të ndryshme, të përhirtë të ndritshme, të gështenj të ose nuanca të dobëta ngjyre violete. Shpunga e rreme rritet në pranverë prej muajit prill deri sa mëshkna të ketë çelë, shpesh rrëzë rrugëve pyjore, drunjve tërënë ose në pyje të prera.

### Efektet dhe simptomet e helmit

Helmi ngacmon sistemin nervor dhe mund të lëndojë edhe rruzat e gjakut dhe mëlçinë. Shenja të helmimit janë marramendje, pamje të dyfishtë dhe të folur mermëritës. Mund gjithashtu të shkaktojë edhe ligështi dhe dhembje barku.



**Giftinformationscentralen**

SWEDISH POISONS INFORMATION CENTRE